



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.655/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani Kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Glllogjani anëtar , me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Qëndresa Xhema, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Drenas, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Drenas, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Qëndresa Xhema, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Drenas, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me shenjë ZL.Anr.655/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it me datën 09.11.2017, në ora 13:25, ka pranuar një ankesë nga Qëndresa Xhema, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Drenas, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me të cilën thekson se në Sankovc, në Vendvotimet VV nr . 0311e/1R, 0311E/2R, 0311E/3D, në fshatin Llapushnik në vendvotimet VVnr. 0317e/03r, 0317e/04D, 0317E/02R, 0317E/01R, në fshatin Komoran në Vendvoimet nr. 0302e/04E, 0302e/03R, 0302e/02R, 0302e/05, në fshatin Tërdevc në vendvotimet nr. 0323e/01R, 0323/02D, në fshatin Llapushnik në vendvotimet nr. 0317e/03R, 0317e/04R, 0317e/02R, 0317e/01R, në fshatin Krajkov në vendvotimet nr. 0309e/03D, 0309e/01R, 0309e/02R, në fshatin Glllogovc në vendvotimet nr. 0301x/02R, 0301X/02d, 0301x/01R, 0301X/04D dhe në Drenas në vendvotimet VV nr. 0301e/02R, 0301E/01r, 0301e/03R, 0301e/04R dhe 0301e/05D.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli i PZAP-it, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesë,

të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes së ankesës gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj.

Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse dhe nuk e ka specifikuar qartë se sa vota i mungojnë në secilën Vendvotim VV, për të vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me keqpërdorimin e votave në ditën e votimit. Më tej në vendvotimet e lartë cekura, ashtu si është përcaktuar në nenin 5.7 pika (b) dhe (c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-së nr.02/2015, ku përcaktohet: “*Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku këto informacione: një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar; hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit*”.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të dispozitave të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli i PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

ZL. Anr.655/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.